



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:040547

Datë: 19.12.2024

Numri i dokumentit: 06627199

PAKR.nr.284/2024

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Kadrije Goga Lubishtani, kryetare e kolegjit, Hashim Çollaku dhe Kymete Kicaj, anëtar, me bashkëpunëtorin profesional Lavdrim Latifi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve, L.K., nga Prishtina, për shkak të veprave penale në vazhdimësi dhe bashkëkryerje ushtrim i ndikimit nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, nga neni 430 par.2 të KPK, të akuzuarit, L.K. dhe F.D., nga Prishtina, në bashkëkryerje keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe e akuzuara M.B., nga Prishtina, për shkak të veprave penale, blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, sipas nenit 333 par.1 të KPK, dhe falsifikimi i dokumenteve, nga neni 390 par.1 të KPK, duke vendosur sipas ankesave, të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, si dhe përgjigjeve në ankesë të prokurorisë, nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, L.K., av.Ramë Gashi, M.B., av.Fatlum Podvorica, dhe F.D., av.Arlind Jupolli, të ushtruara kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.339/2023, të dt.25.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me dt.05.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Me aprovimin e ankesave të Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, si dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, e sipas detyrës zyrtare, anulohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.339/2023, të dt.25.03.2024, kurse çështja penale i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim e vendosje.

Pasi që çështja penale është anuluar, përgjigjet në ankesë, nuk kanë paraqitur relevancë për shqyrtim.

Ar sy e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.339/2023, të dt.25.03.2024, në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, janë liruar nga akuza:

- i akuzuari L.K., për veprat penale, në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, ushtrimi i ndikimit nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, në bashkëkryerje keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, sipas nenit 414 par. 2 lidhur me nenin 31 të KPK, dhe mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare nga neni 430 par. 2 të KPK,

-të akuzuarit, L.K. dhe F.D., në bashkëkryerje për veprën penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 414, par.1 lidhur me nenin 31 të KPK,

-e akuzuara M.B., për veprën penale blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale, nga neni 333, par.1 të KPK. Në kuptim të nenit 363 par.1 pika 1.3 të KPPK, pasi që nuk është provuar se të akuzuarit kanë kryer veprat penale të cilat u vihen në barrë.

Në kuptim të nenit 364 par.1 pika 1.1 të KPPK, e akuzuara M.B., është shpallur fajtores për veprën penale falsifikimi i dokumenteve sipas neni 390 par.1 të KPK, dhe i është shqiptuar dënimi me gjobë në shumën prej 3.000 (tremijë) Euro, i cili dënim do të ekzekutohet brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në dënimin e shqiptuar me gjobë, i është llogaritur koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak prej dt.01.03.2021, deri me dt.31.03.2021.

Nëse e akuzuara nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, gjykata do të veprojë në bazë të nenit 43 par 3 të KPK, ashtu që dënimin me gjobë do të zëvendësohet në dënimin me burgim, duke llogaritur për çdo ditë të kaluar në burg nga 20 Euro.

Urdhërohet që pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, vetura e sekuestruar e tipit “VWT-Roc”, me ngjyrë të bardhë, me tabela të regjistrimit 01-706 NQ, të i kthehet pronares M.B..

Është obliguar e akuzuara që t’i paguajë shpenzimet e procedurës penale, aq sa do të jenë sipas llogarisë përfundimtare në arkë të gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shpenzimet në shumë prej 200 (dyqind) Euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit, shumën prej 50 Euro, brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I dëmtuari B.M., nga Prishtina, rr.“.....”, lagja “.....”, objekti C.2, nr.10, banesa.41, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, është udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë ushtruar:

- Prokuroria Themelore në Prishtinë, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, vendimit lidhur me sanksionin penal, si dhe konfiskimit dhe kërkesave pasurore juridike, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.339/2023, i dt.25.03.2024, të anulohet dhe çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rigjykim e vendosje, dhe

- mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljeve të ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe vendimit lidhur me sanksionin penal, duke propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar, dhe aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.339/2023, i dt.25.03.2024, të ndryshohet ashtu që e akuzuara të lirohet nga aktakuza apo sa i përket pikës II të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar, çështja penale ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në ri procedurë dhe rivendosje.

-Përgjigje në ankesë të prokurorisë kanë ushtruar:

- mbrojtësi i të akuzuarit L.K., av. Ramë Gashi, dhe ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.339/2023, të dt.25.03.2024, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet,

- mbrojtësi i të akuzuarës F.D., av. Arlind Jupolli, duke propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.339/2023, të dt.25.03.2024, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet, dhe

- mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, i cili ka propozuar që ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Krime të Rënda, PKR.339/2023, të dt.25.03.2024, të refuzohet si e pabazuar, kurse aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Kolegji i Gjykatës së Apelit, në kuptim të nenit 390 të KPPK, ka caktuar seancën e kolegjit për datën 05.11.2024. dhe në mënyrë të rregullt i ka njoftuar të gjitha palët nga shkresat e lëndës.

Në seancë të kolegjit kanë prezantuar, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, L.K., av. Ramë Gashi, M.B. av. Fatlum Podvorica dhe F.D., av. Arlind Jupolli, kurse nuk kanë prezantuar, Prokurori i Apelit, dhe i dëmtuari B.M., edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.K., av. Ramë Gashi, ka deklaruar se aktakuza ka deformitete juridike, akuza ka qenë e pa qëndrueshme nga fillimi dhe se të gjithë ato që ka thënë deri tani, mbeten në tërësi tyre. Ankesa e prokurorisë, është përshkrim i aktakuzës dhe se ashtu si aktakuza

edhe ankesa është e pa qëndrueshme, me propozim që të refuzohet e njëjta, kurse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë të vërtetohet.

I akuzuari L.K., e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, av. Ramë Gashi.

Mbrojtësi i të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, deklaron se mbetet në tersi pranë ankesës së ushtruar, me propozim që të vërtetohet pjesa liruese dhe të aprovohet ankesa për pjesën dënuese për të mbrojturën e tij, dhe po ashtu të mos i falet besimi ekspertizës nga forenzika.

E akuzuara M.B., e mbështet fjalën e mbrojtësit të saj, av.Fatlum Podvorica.

Mbrojtësi i të akuzuarës F.D., av. Arlind Jupolli, propozon që të refuzohet ankesa e prokurorisë dhe të lirohet e mbrojtura e tij.

E akuzuara F.D., e mbështet fjalën e mbrojtësit të saj, av. Arlind Jupolli.

Gjykata e Apelit në kuptim të nenin 394 të KPPK, duke vlerësuar pretendimet ankimore nga ankesat e ushtruara nga ana e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, dhe mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, përgjigjeve në ankesën e prokurorisë, të paraqitur nga ana e mbrojtësve së të akuzuarve, L.K., av.Ramë Gashi, M.B., av.Fatlum Podvorica, dhe F.D., av. Arlind Jupolli, aktgjykimit të ankimuar, propozimit me shkrim të Prokurorisë së Apelit në Prishtinë, si dhe shkresave tjera të lëndës ka gjetur se:

Kolegji i kësaj gjykate në kuptim të nenit 394 të KPPK, ka vlerësuar ankesat e ushtruara, aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, si dhe shkresat e tjera të lëndës, dhe ka ardhur në përfundim se:

Aktgjykimi i ankimuar përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, si dhe shkelje të tjera të cilat kushtëzojnë anulimin e tij.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, ka ushtruar Prokuroria Themelore – Departamenti i Krimeve të Rënda, të cilat shkelje konsistojnë në kuptim të nenit 384 par.2 pika 2.1 lidhur me nenin 269 par.1 të KPK, sepse gjykata e shkallës së parë, përkundër asaj që ka pasur aktvendimin e mëparshëm, sipas të cilit është dashur që të eliminoj të gjitha mangësitë në aktgjykim, rezulton se nuk e ka zbatuar dispozitën ligjore, nga neni 406 i KPPK, për të vepruar sipas udhëzimeve të gjykatës së Apelit. Të gjitha udhëzimet e dhëna janë bazuar në drejtim të vlerësimit të të gjitha provave, për të ndriçuar dhe vërtetuar se në veprimet e të akuzuarve, janë formuluar apo nuk janë formuluar elementet qenësore të veprave penale, të përshkruara sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë.

Në rishqyrtim gjyqësor përkundër asaj që është udhëzuar gjykata e shkallës së parë, që të nxjerr edhe prova të tjera, për të vërtetuar ekzistimin e veprave penale, rezulton se nuk është vepruar sipas udhëzimeve të marra, që nënkupton se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në dispozitivin

ligjore nga neni 384 par.2 pika 2.1 të KPPK, ngase nuk janë zbatuar në mënyrë të drejt dhe të qartë dispozitat ligjore të Kodit Penal, për të karakterizuar veprimin inkriminues të secilit të akuzuar sikurse është përshkruar në pikat e dispozitivit të aktgjykimit. Nga kjo rezulton se me këtë aktgjykim të nxjerr nga ana e gjykatës së shkallës së parë, pasi që nuk është vepruar sipas udhëzimeve të marra, dhe se aktgjykimi përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, të parapara në nenin 384 par.2 pika 2.1 dhe 2.7 lidhur me nenin 369 të KPPK, atëherë rezulton se edhe aktgjykimi është i pa qartë, në dispozitiv të të njëjtit, i pa kuptueshëm, dhe nuk është në harmoni me asnjë pikë të dispozitivit të aktgjykimit, që nënkupton se shkeljet esenciale nga dispozita ligjore e sipër theksuar janë evidente, për të cilat shkelje kolegji i kësaj gjykate përkujdeset edhe sipas detyrës zyrtare të dispozitave të procedurës penale, në kuptim të nenit 394 të KPPK.

Nga arsyetimi i aktgjykimit rezulton se pasi që nuk janë dhënë arsye të mjaftueshme, për çdo pikë të aktgjykimit, atëherë gjykata e shkallës së parë, nuk ka dhënë arsye të qarta dhe të plota, se për çfarë arsye konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara, të gjitha faktet për të arsyetuar ekzistimin e veprave penale, që rezulton se nuk është zbatuar parimi, që provat procedohen, kurse fakte vërtetohen, përkundër asaj që në aktgjykim, janë proceduar shumë dëshmitarë, shumë prova materiale. Po ashtu gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë arsye të qarta dhe të sakta, se për çfarë arsyer nuk ka aprovuar propozimin që në shqyrtim gjyqësor të jetë prezent eksperti i forenzikës për të bërë precizimin dhe sqarimin e nënshkrimeve të cilat janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës. Me pjesëmarrjen e tij, me siguri se situata do të qartësohej edhe më shumë. Përkundër asaj që nga ky aktgjykim, aktgjykimi ka mangësi në secilën pikë të tij, duke filluar nga pika I e dispozitivit, ku si i akuzuar, është i akuzuari L.K., për shkak të veprës penale në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje ka kryer veprën penale ushtrimi i ndikimit, nga neni 424 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, gjykata e shkallës së parë, nuk e ka qartësuar veprimin e bashkë kryesit L.K., së bashku me të akuzuarin tjetër A.K., që theksohet se kanë kërkuar dhe pranuar të holla dhe dhurata për vete dhe për tjetrin, nga B.M., derisa kanë arritur shumën prej 40.000 Euro, si dhe kanë pranuar si dhuratë një veturë të tipit “VWT- Roc”, me ngjyrë të bardh me tabela të regjistrimit 01-706 NQ, me vlerë prej 25 Euro, atëherë është dashur të sqarohet lidhur me këtë çështje dhe të vihet në pah ushtrimi i ndikimit i të akuzuarit në kolegjin e Gjykatës Supreme, për uljen e dënimit për të dënuarin B.M., si dhe të shtyhet ekzekutimi i dënimit, pa vërtetuar se si është ushtruar ky ndikim, te kush është ushtruar ky ndikim, për mos ekzekutimin e dënimit me burgim prej 4 (katër) vite e 7 (shtatë) muaj, ndërsa nga Gjykata e Apelit, është zvogëluar dënimi në 3 (tri) vite e 7 (shtatë) muaj.

Po ashtu edhe në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 414 par.2 lidhur me nenin 31 të KPK, është dashur që gjykata e shkallës së parë të sqaroj veprimin konkretizues të cilin eventualisht e ka ndër marrë këtu i akuzuari L.K., duke shfrytëzuar veturën zyrtare të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, konkretisht të drejtorit të sekretariatit të KPK, të cilin gjatë përdorimit dhe gjatë arratisjes e kanë përdorë letrën me logon zyrtare dhe dritat rrotative, për të kaluar në kufi të Republikës së Shqipërisë, me qëllim që B.M., ti shmanget ekzekutimit të dënimit.

Në vazhdimësi duke vlerësuar aktgjykimin, i akuzuari L.K., akuzohet dhe për veprën penale mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, nga neni 430 par.2 të KPK, që për të tri këto vepra penale,

nën I, II dhe III, të dispozitivit të aktgjykimit është liruar, ngase nuk është provuar se të njëjtat i ka kryer, dhe aktgjykimi është marrë në kuptim të nenit 460 par.1 të KPPK.

Në vazhdimësi në vlerësim të aktgjykimit, lidhur me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, rezulton se të akuzuarit L.K. dhe F.D., janë liruar nga akuza për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, në bashkëkryerje nga neni 414 par.1 lidhur me nenin 31 të KPK, rezulton se të gjitha veprimet të cilat janë ndërmarrë nga ana e këtu të akuzuarve, nuk është sqaruar mënyra e kontaktimit dhe veprimit, duke kaluar nga një operator në operatorin tjetër, sikurse është lidhja e marrëveshjes me operatorin ekonomike “Mobelant SHPK”, dhe kalimi tek operatorit “Granit SHPK”, dhe “Solos Studios”, përkundër asaj që një pjesë të mobileve e kanë marrë nga operatori i parë. Atëherë, parashtrohet çështja se pse është filluar realizimi i kontratës me operatorin e parë, pa filluar punën operatori tjetër, e këto veprime nuk janë sqaruar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, përkundër asaj që mundohet të vihet deri te një përfundim krejt tjetër.

Edhe sa i përket të akuzuarës M.B., e akuzuar për shkak të veprës penale, blerja, pranimi, ose fshehja e sendeve të përfituara në kryerjen e veprës penale, sipas nenit 333 par.1 të KPK, nuk është sqaruar se cilat veprime i ka ndërmarrë e akuzuara M.B., dhe si është ardhur deri te pranimi i kësaj dhurate apo blerja e së njëjtës, apo fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale.

Gjithashtu, po qesë vlerësohet edhe vepra penale falsifikimi i dokumenteve sipas nenit 390 par.1 të KPK, sipas së cilës e akuzuara M.B., është shpallur fajtores, atëherë parashtrohet pyetja se si është e mundur që të shpallet fajtores për veprën penale e cila i vihet në barrë, duke pasur relacione të pa shkëputura me vepra të tjera penale, dhe cila është lidhja kauzale në mes të ekzistimit të kësaj vepre penale me vepra të tjera penale.

Gjykata e shkallës së parë, është dashur që të sqaron çdo pikë të aktgjykimit, të jep arsye lidhur me çdo pikë të aktgjykimit, duke sqaruar me të gjitha provat të cilat i ka proceduar, për të vërtetuar faktet për ekzistimin apo mos ekzistimin e veprave penale, të cilat u vihen në barrë. Kjo para se gjithash që të gjitha provat të cilat janë proceduar, duke filluar nga dëgjimi i të akuzuarve, L.K., tani në arrati A.K., M.B. dhe F.D., ashtu që pas vlerësimit të deklaratave të secilit prej tyre, si dhe prova materiale nga shkresat e lëndës, të vihet deri te një formulim sa më i drejtë, për të zgjidhur çështjen penale.

Janë evidente se në këtë çështje penale rezulton se gjykata e shkallës së parë është dashur që për veprën penale të përshkruar në pikën I, II, III, IV dhe V, të dispozitivit të aktgjykimit të jep arsye për çdo pikë të aktgjykimit, për të vërtetuar edhe ekzistimin e veprës penale, vazhdimësinë e ekzistimit të veprës penale, si dhe institutin e bashkëkryerjes, dhe të nxjerr një aktgjykim sa më të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në këtë çështje penale përkundër asaj që janë bërë përpjekje që të sqarohen çështjet të cilat ngritën dhe identifikohen me veprimet e të akuzuarve, sikurse është i akuzuari L.K., që si kryes apo bashkë kryes i veprave penale, ka kryer të njëjtat, atëherë gjykata e shkallës së parë është dashur që të paraqes faktet dhe rrethanat të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale, e më pastaj e të vendos edhe lidhur për të njëjtën. Duke vazhduar dhe përcjellë këtë çështje, rezultojnë se veprimet e të akuzuarit, të parë, të akuzuarve, F.D. dhe M.B., nuk janë pasqyruar në mënyrë të drejtë në këtë çështje penale, e sidomos gjykata e shkallës së parë, është dashur që të pakujdeset

që të vërtetohet institutin e bashkëkryerjes së veprave penale, për të ardhur në përfundim mënyrën e të vepruarit nga ana e të akuzuarit të parë dhe të akuzuarve të tjerë, cili ka qenë roli i të bashkë të akuzuarit që është në arrati, që të konfirmohet identiteti i dëshmitarit bashkëpunuese, pasi që i njëjti edhe është zbuluar, dhe dëshmia e tij është provë kroçiale në vendosjen e kësaj çështje penale, që të ftohet eksperti i forenzikës i cili ka punuar ekspertizën dhe të sqarohet në secilën edhe për nënshkrimet të cilat janë pjesë përbërëse në këtë çështje penale. Gjithashtu të vërtetohet secili veprim i secilit të akuzuar, se në çfarë mase është bërë ushtrimi i ndikimit i të akuzuarit, në drejtim sikurse ekziston në përshkrim të pikave të aktgjykimit, në drejtim të tani të arratisurit A.K., të akuzuarave, F.D., dhe M.B.. Po ashtu cilat janë arsyet e dhëna nga ana e të akuzuarit L., lidhur me veprën penale të mos deklarimit të pasurisë, pasi që i njëjti arsyetohet se ka qenë periudha Covid 19, dhe ka qenë në izolim, ndërsa kur ka dalë nuk ka pasur kohë, atëherë nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është dashur që të merret informacioni nga ana e kompetentëve, se a është drejtuar i njëjti me ndonjë shkresë për zgjatjen e afatit.

Të gjitha mangësitë të cilat gjykata e shkallës së parë, i ka bërë në aktgjykimin e përpiluar, rezultojnë se janë evidente dhe janë të bartura edhe nga aktgjykimi i kaluar, kurse kolegji i kësaj gjykate pas mbajtjes së seancës së kolegjit, vlerësimit të shkresave të lëndës, ankesave të ushtruara, ka ardhur në përfundim që në këtë çështje penale, gjykata e shkallës së parë, duhet të procedoj me dëshmitarët e propozuar, që mundësisht të njëjtit ti siguron në shqyrtim gjyqësor për ti dëgjuar lidhur me këto mangësi, për veprat penale të cilat janë objekt i shqyrtimit, e jo të bëhet leximi i deklaratave të të njëjtëve, ngase gjatë të gjitha fazave të procedurës, të gjitha palëve u jepet mundësia që të nxjerrin prova të reja, të cilat shkojnë në dobi të zgjedhjes së çështjes penale, e edhe në favor të palëve në procedurë, sikurse janë të akuzuarit.

Duhet që të bëhet konfirmimi i identitetit të dëshmitarit bashkëpunues, i cili në këtë çështje penale ka dhënë deklaratë, dhe të mbulohet me dispozitat përkatëse ligjore, ngase nga kjo çështje penale rezulton se i njëjti është dëshmitar kyç për të vendosur çështjen penale.

Nga këto sugjerime, mund të vihet në përfundim të zgjidhjes së çështjes penale, në mënyrë sa më të drejtë dhe me qëllim që mos të ketë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, të cilat janë të ngritura nga ankesa e prokurorisë, si dhe ankesa e mbrojtësit së të akuzuarës, M.B., av. Fatlum Podvorica, si dhe të vlerësuar sipas detyrës zyrtare, kolegji i kësaj gjykate, propozon që prezenca e ekspertit të forenzikës të jetë në shqyrtim gjyqësor dhe të vlerësohen të gjitha nënshkrimet në seancë të kolegjit.

Gjithashtu, pasi të vërtetohet se cili i akuzuar ka kryer cilën vepër penale, të cilat janë të përshkruara në pikën I, II dhe III të dispozitivit të aktgjykimit, që kanë të bëjnë me të akuzuarin L.K., IV, që kanë të bëjnë me të akuzuarin L.K. dhe të akuzuarën F.D., V dhe VI, që kanë të bëjnë me të akuzuarën M.B., duhet sqaruar cili është roli i të akuzuarit L., si është kryer vepra penale në vazhdimësi, cili është ushtrimi i ndikimit dhe në cilin person është bërë ushtrimi i ndikimit, si është bërë keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga ana e të akuzuarit L. dhe F.D., cilat veprimet inkriminuese i ka ndërmarr e akuzuar M.B., e pasi që të sqarohet ekzistimi i secilës vepër penale, atëherë në vepër penale ku kemi bashkë kryes, të konkretizohet veprimi i secilit të akuzuar, për ekzistimin apo mos ekzistimin e të njëjtës.

Është evidente që në këtë çështje penale janë dëgjuar, dëshmitari bashkëpunues B.M., dëshmitarët, A.M., B.P., B.B., S.B., (noter), E.Sh., L.D., V.C., I.H., B.D., F.K., I.S., Z.K.–D.,

F.L., F.S. F.A. A.Z., si dhe të gjitha provat materiale, mirëpo parashtrohet pyetja se cilat janë relacionet të cilat gjykata e shkallës së parë ua ka dhënë të gjitha këtyre provave, për të vërtetuar elementet inkriminuese të veprave penale, që u vihen në barrë të akuzuarve, si dhe lidhja e tyre me provat materiale, të cilat janë të bollshme në këtë çështje penale.

Të vlerësohet deklarata e dëshmitarit S.B., noter në Prishtinë, deklarata e dëshmitares E. Sh., e cila ka deklaruar se nuk e dinë si kanë ardhur mobilet, e dëshmitares L.D., e cila ka deklaruar se nuk dinë se nga kanë ardhur dhe cila kompani i ka sjellë mobilet, të ftohet dhe të dëgjohet edhe njëherë ekspertja e prokurimit publik B.Sh., pasi që është përgjegjëse në arhivën e prokurimit, dhe pasi që të eliminohen të gjitha këto mangësi të cilat janë evidente në këtë çështje penale, të bihet një vendim i drejtë.

Pasi që të veprohet sipas këtyre provave, duhet qartësuar veprimin e ndërmarrë të akuzuarës F.D., dhe pozitës të cilën e ka në kuadër të sistematizimit të vendit të punës, veprimeve të ndërmarra nga ana e të akuzuarës M.B., mënyrën se si i ka pranuar të hollat, nëse i ka pranuar, me ndërmjetësues për të përfituar benefecione B.M., dhe djali i tij, që të gjitha këto çështje të cilat nuk janë zgjedhur nga ana e gjykatës së shkallës së parë, dhe të bihet vendimi sa më i drejtë.

Në këtë çështje penale sipas ankesës së prokurorisë, dhe ankesës së mbrojtësit së të akuzuarës M.B., av. Fatlum Podvorica, aktgjykimi është ankimuar për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se pasi që aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë përfshihet me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale, atëherë i njëjti edhe sa i përket gjendjes faktike nuk është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, por të njëjtat janë si pasojë e ekzistimit të shkeljeve esenciale, si dhe shkeljeve të ligjit penal.

Kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, duhet të eliminoj shkeljet e evidentuara, duke vepruar sipas udhëzimeve të dhëna, e mundësisht sipas rrjedhës së procedurës, të nxjerrë edhe prova të tjera, të cilat janë domethënëse në zgjedhjen e çështjes penale, ngase kjo mundësi ligjore, i jepet edhe sipas dispozitave të KPPK.

Vendimi lidhur me sendet të cilat janë të përfshira në kryerjen e veprave penale, të vendoset pasi që çështja penale të zgjidhet.

Nga arsyet e cekura më lartë, është vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi, në kuptim të nenit 402 të KPPK.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.284/2024, të datës 05.11.2024

Procesmbajtësi,
Lavdrim Latifi

Anëtarët e kolegjit,
Hashim Çollaku

Kryetare e kolegjit,
Kadrije Goga Lubishtani

Kymete Kicaj